



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1695/4 Prot.

Tiranë, më 28.12.2017

VENDIM

Nr.247, datë 28.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 77, DATË 07.04.2017,
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DIBËR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 77, datë 07.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017”, në institucionin e Bashkisë Dibër.

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 89, datë 25.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Dibër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 26.04.2016 e në vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur kryerjen e procesit të kontrollit të akteve të emërimit, të cilat janë marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore për respektimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në Bashkinë Dibër, për periudhën nga data 26.04.2016 (momenti i përfundimit të mbikëqyrjes së realizuar më parë në këtë institucion) e në vazhdim. Ky proces është përmbysur me Vendimin Nr. 77, datë 07.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

“1.Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Dibër, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me 28 (njëzetë e tetë) rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin, të veprojë si më poshtë:

- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.171, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist pranë Sektorit të Administrimit të Ujërave”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.208, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Inspektor Veterinar”, pranë Sektorit të Shëndetësisë, Higjienës, Veterinarisë, Prodhimit Bujqësor dhe Ushqimit.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.163, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.162, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist i Pyjeve, pranë Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Bujqësisë”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.177, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr. 365, datë 10.08.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.211, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.230, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjësës *****; në pozicionin “Specialist, i Sporteve pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.166, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësës *****; në pozicionin “Specialist, i Turizmit pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.197, datë 24.06.2016, për emërimin e punonjësës *****; në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.169, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist i Monitorimit pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Pronave”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.273, datë 12.07.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Specialist i Hartimit të Politikave pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Pronave”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.207, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të*

Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Pronave”.

- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.155, datë 16.06.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Hartimit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.195, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Specialist personeli”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.181, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.165, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.245, datë 04.07.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.247, datë 06.07.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Specialist i Auditit pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.14, datë 23.01.2017, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të TIK, Drejtoria e Shërbimeve Juridike”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.41, datë 01.03.2017, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Specialist pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.34, datë 14.02.2017, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Drejtore i Drejtorisë së Bujqësisë”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.293, datë 13.07.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Specialist i Planifikimit të të Ardhurave Lokale dhe Rakordimit të Tatim-Taksave, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.96, datë 26.04.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Specialist i Buxhetit pranë Sektorit të Financës”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.396, datë 17.08.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Specialist për Çështje Gjinore pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, Drejtoria e Shërbimeve Juridike”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.12, datë 21.01.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “Specialist, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”.*
- ✓ *Të anulojë aktin administrativ nr.43, datë 07.03.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”.*

- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.157, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Përgjegjës, pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

2.Njësia përgjegjëse, të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke e ndarë procesin e rregullimit të ligjshmërisë në dy faza.

3.Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2017, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

4.Njësia përgjegjëse, të fillojë procesin e rekrutimit për 28 pozicionet e lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në Kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.

- ✓ Të bëhen publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Dibër dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:

a) Akti i shpalljes për plotësim, i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të

Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.

- b) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
- c) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
- d) Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.*

*5.Njësia përgjegjëse e Bashkisë Dibër, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi sipas fazave që do të realizohet.*

6.Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 77, datë 07.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017”, me Vendimin Nr. 205, datë 12.10.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 77, datë 07.04.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017’”, në Bashkinë Dibër, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Helga Peti dhe Stela Ndoka, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 17.10.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Dibër.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Dibër dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1695/2 prot., datë 12.10.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 18.10.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Dibër.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në **pikën 1 të vendimit** objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë që të anulohë 28 akte emërimi në kundërshtim me ligjin, pa iu nënshtruar procedurave të konkurrencës.

Nga verifikimi në objekt rezultoi se Kryetari i Bashkisë Dibër ka anuluar aktet e emërimit për 17 nga këta punonjës, si akte të dala në kundërshtim me procedurat e parashikuara në Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht:

- 1.Me aktin nr. 53/3 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 208, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Inspektor Veterinar*”;
- 2.Me aktin nr. 53/4 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 163, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”;
- 3.Me aktin nr. 53/5 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 177, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”;
- 4.Me aktin nr. 53/6 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 211, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”;
- 5.Me aktin nr. 53/7 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 230, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist, i*

- Sporteve pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike”;*
- 6.Me aktin nr. 53/8 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 166, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist, i Turizmit pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike”;*
 - 7.Me aktin nr. 53/9 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 197, datë 24.06.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Financës”;*
 - 8.Me aktin nr. 53/10 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 273, datë 12.07.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist i Hartimit të Politikave pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit”;*
 - 9.Me aktin nr. 53/11 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 207, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Pronave”;*
 - 10.Me aktin nr. 53/12 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 155, datë 16.06.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist pranë Sektorit të Hartimit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;*
 - 11.Me aktin nr. 53/13 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 195, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist Personeli”;*
 - 12.Me aktin nr. 53/14 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 34, datë 14.02.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë”;*
 - 13.Me aktin nr. 53/15 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 293, datë 13.07.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist i Planifikimit të të Ardhurave Lokale dhe Rakordimit të Tatim-Taksave, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar”;*
 - 14.Me aktin nr. 53/16 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 96, datë 26.04.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist i Buxhetit pranë Sektorit të Financës”;*
 - 15.Me aktin nr. 53/17 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 12, datë 21.01.2016, për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”;*
 - 16.Me aktin nr. 53/18 prot., datë 15.05.2017, është anuluar akti nr. 43, datë 07.03.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm”;*
 - 17.Me aktin nr. 45 prot., datë 26.04.2017, është anuluar akti nr. 157, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Përgjegjës, pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”*. Nga shqyrtimi i akteve të vëna në dispozicion nga ana e burimeve njerëzore të Bashkisë Dibër, u konstatua se punonjësi Sh. Uklala në datën 17.03.2017 ishte emëruar “*Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”* në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Në

vijim, me Urdhrin nr. 46, datë 09.05.2017, kjo njësi e kishte anuluar aktin e emërimit në pozicionin e sipërpërmendur të këtij punonjësi me nr. 52, datë 17.03.2017.

Në momentin e verifikimit grupi i punës konstatoi se nuk ishte bërë anulimi i akteve të emërimit të dala në kundërshtim me ligjin për **11 punonjësit** e tjerë *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe ***** . Ndërkohë, njësia e burimeve njerëzore ka bërë shpalljen e të gjitha pozicioneve të përmendura më sipër, me qëllim plotësimin e tyre në përputhje me përcaktimet ligjore (sa më sipër do të shpjegohet në mënyrë të detajuar gjatë analizës së zbatimit të pikave 2 dhe 4 të vendimit).

Në **pikat 2 dhe 4** të Vendimit Nr. 77, datë 07.04.2017, objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin të shpallen të lira dhe të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, në përputhje me përcaktimet ligjore, duke bërë kujdes për të përmbushur rregullat e përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore përkatëse.

Në zbatim të rekomandimit të mësipërm, me Urdhrin nr. 03 prot., datë 03.04.2017, është krijuar *Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë*, Urdhrin nr. 44 prot., datë 26.04.2017, *“Për krijimin e Komitetit të Pranimit”* dhe Urdhrin nr. 68 prot., datë 25.05.2017 është ngritur *Komiteti i Pranimit në Shërbimin Civil*. Më tej, me shkresat Nr. 1137 Prot., datë 08.03.2017, Nr. 1138 Prot., datë 08.03.2017, Nr. 1812 Prot., datë 12.02.2017, Nr. 1890 Prot., datë 18.04.2017, Nr. 2385 prot., datë 17.05.2017, të titullarit të institucionit, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, bazuar në nenin 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të Këshillit të Ministrave, është bërë shpallja për plotësimin e pozicioneve të lira të punës, si më poshtë:

1. *Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë;*
2. *Specialist në Sektorin e Bujqësisë (4 vende)*
3. *Specialist pranë Sektorit të Administrimit të Ujërave*
4. *Specialist Pyjesh*
5. *Inspektor Veteriner*
6. *Specialist Auditi i Brendshëm*
7. *Specialist Personeli*
8. *Përgjegjës i Sektorit TIK*
9. *Specialist Arsimi*
10. *Specialist Turizmi*
11. *Specialist Sportesh*
12. *Specialist për Çështjet Gjinore*
13. *Përgjegjës i Sektorit të Financës*

14. *Specialist Buxheti*
15. *Specialist i Planifikimit të të Ardhurave*
16. *Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit*
17. *Specialist i Hartimit të Politikave*
18. *Specialist Monitorimi*
19. *Sekretar i Përgjithshëm*
20. *Specialist pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile (4 vende)*
21. *Specialist Jurist (pozicioni i mbajtur realisht nga punonjësja Entuela Xhika)*

Pozicioni “Përgjegjës pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, referuar strukturës dhe organikës aktuale të vënë në dispozicion të grupit të punës (miratuar me Urdhrin nr. 21, datë 23.02.2017), nuk ekziston më.

Nga verifikimet e kryera, rezulton se janë dërguar në mënyrë elektronike pranë, “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” (kopje të akteve përkatëse dhe të emaileve të printuara janë administruar nga grupi i punës) lista e kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak dhe lista e kandidatëve të shpallur fitues me më shumë se 70% të pikëve nga komisioni përkatës, vërtetuar kjo nga praktika e plotë e konkurrimit me nr. 41 shpallja, datë 15.05.2017, bashkëngjitur shkresës nr. 2385 prot., datë 17.05.2017, të administruara si provë shkresore nga grupi i punës.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Dibër, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” ka hartuar planin e punës së pranimeve në shërbimin civil me Vendimin nr. 909 prot., datë 23.02.2017, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2017”, por në të nuk janë reflektuar pozicionet e përmendura në pikat 1 dhe 4 më sipër, të cilat ishin plotësuar në kundërshtim me ligjin, sikundër ishte rekomanduar njësia përgjegjëse nga ana e Komisionerit **në pikën 3 të vendimit**.

Pavarësisht parregullsive gjatë zbatimit të pikës 2 dhe 3 të vendimit, duke qenë se tashmë është rikthyer situata e ligjshmërisë, njësia përgjegjëse duhet të mbajë parasysh që në të ardhmen të zbatojë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 77, datë 07.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar rekomandimet e vendimit të Komisionerit. Ashtu sikundër u evidentua edhe më sipër në përmbajtjen e këtij materiali, problemet apo parregullsitë e konstatuara në mënyrën e zbatimit të këtij vendimi, duhet të mbahen parasysh nga njësia përgjegjëse për të mos u përsëritur më në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 77, datë 07.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 28, datë 10.02.2017”, në Bashkinë Dibër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Dibër, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 77, datë 07.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Dibër dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha